

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5445
E shtunë, 7 prill 2018
çmimi 0.40 €

ShBA-ja rikonfirmon përkrahjen për transformimin e FSK-së në ushtri

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AKTUALE

PËR NJË MARRËVESHJE TË ARRITUR, IMPROVIZIME TË LODHTA!

F. 6



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

ROMËT KËRKOJNË PËRKRAHJE MË TË MADHE NGA INSTITUCIONET E KOSOVËS

F. 6

NGRIHET AKTAKUZË PËR RASTIN 'PRONTO'

F. 7

EKONOMI

BERZH-I DO TA NDIHMOJË KOSOVËN NË SEKTORIN PRIVAT, EKONOMINË E GJELBËR DHE INFRASTRUKTURË

F. 9

FERMERËT T'I FILLOJNË PËRGATITJET PËR MBJELLJET PRANVERORE

F. 9

Prof. dr. Imer RUSINOVCI

KULTURË

TRIOLOGJI PËR ÇDO SHTËPI

F. 13

Lulëzim ETEMAJ

SPORT

FETAHU: DO TA ZHVILLOJMË BASKETBOLLIN

F. 15

LIRIA BARAZOI EDHE ME VLLAZNINË

F. 15



FLET PËR "EPOKËN E RE", JAKUP KRASNIQI

FAQE 4-5

Zhvillimet e fundit politike më së paku i janë dashur vendit

Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh kryetar i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, ka thënë se zhvillimet e fundit nuk i janë dashur shtetit dhe pasojat e tyre do të shihen më vonë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se karshi këtyre zhvillimeve Kuvendi dhe Qeveria janë treguar të pafuqishme meqë fuqia

është koncentruar në pushtetin ceremonial. Krasniqi ka porositur Haradinajn ta qeverisë vendin si kryeministër pasi këtë të drejtë ia jep Kushtetuta. Në situatën kur as pozita dhe as opozita nuk e kanë shumicën në Kuvend, ish-kryeparlamentari ka thënë se edhe mund të shkohet në zgjedhje por, sipas tij, nuk do të ketë zgjidhje të duhur. "Ata që po kërkojnë zgjedhje ishin para pak muajve në qeverisje dhe nuk e zgjidhen asnjë problem", është shprehur Krasniqi

LDK-ja paralajmëron mocion mosbesimi ndaj Qeverisë

Shefi i Grupit Parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka paralajmëruar se nëse partitë politike nuk pajtohen për caktimin e datës së zgjedhjeve të reja, ky subjekt

politik do të ngrehë mocionin mosbesimi ndaj Qeverisë së Kosovës. Ai ka deklaruar se Qeveria e drejtuar nga Haradinaj është Qeveri e pakicës dhe, si e tillë, nuk mund

t'i adresojë temat e mëdha për vendin. Mirëpo zyrtarët e koalicionit qeverisës kanë mohuar mundësinë e mbajtjes së zgjedhjeve të reja



Jagxhillari: Këtë vit do të bëhen reforma të thella në administratë

Ministri i Administratës Publike, Mahir Jagxhillar, ka bërë me dije se 2018-a do të jetë vit i reformës së administratës publike. Ai ka

theksuar se për të pasur reformë funksionale dhe efektive duhet të ketë zyrtarë publikë të cilat janë pranuar në punë sipas meritës

RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Çarëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel & Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjobiznesi.com
info@kolegjobiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Joseph: Kosova nuk duhet të përkulet para presionit turk

Edward Joseph, ekspert i çështjeve të Ballkanit në Universitetin "Johns Hopkins", ka thënë se Kosova nuk duhet të përkulet para presionit të Ankarasë dhe nuk duhet të bëjë veprime që mund t'i dëmtojnë marrëdhëniet e saj me Bashkimin Evropian

WASHINGTON, 6 PRILL - Mënyra e deportimit të gjashtë shtetasve turq, të cilët nuk kanë shkelur ligjet e vendit, tregon në mënyrë të qartë pozitën e pambrojtur gjeopolitike të Kosovës në mes të Turqisë, në njërin anë, dhe të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara, në anën tjetër, thotë Edward Joseph, ekspert i çështjeve të Ballkanit në Universitetin "Johns Hopkins". Ai i tha Zërit të Amerikës se Kosova nuk duhet të përkulet para presionit të Ankarasë dhe nuk duhet të bëjë veprime që mund t'i dëmtojnë marrëdhëniet e saj me Bashkimin Evropian. Në pyetjen se arrestimi dhe deportimi i gjashtë shtetasve turq javën e kaluar në Kosovë ka shkaktuar reagime të shumta, Joseph tha kjo tregon qartë poz-

itën e pambrojtur gjeopolitike të Kosovës në mes të Turqisë, në njërin anë, dhe të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara, në anën tjetër. "Natyrshisht, Kosova ka marrëdhënie të ngushta me Turqinë. Shumë qytetarë të Kosovës shkojnë për vizita dhe kalojnë pushimet atje. Ka një lidhje të ngushtë dhe një prirje për afrim me njerëzit dhe Qeverinë e këtij vendi. Fatqësisht, Qeveria e këtij vendi nën presidentin Erdogan po bëhet gjithnjë e më autoritare dhe problematike dhe është e qartë se presioni nga Ankaraja ka shtyrë autoritetet në Prishtinë t'i arrestojnë këta mësues, të cilët, sipas njoftimeve, nuk kanë bërë asnjë shkelje, nuk kanë shkelur asnjë ligj të Kosovës. Kështu që kjo ka



shkaktuar probleme në Kosovë, ku duket se ajo thjesht është përlurur para presionit turk për t'i deportuar njerëzit, të cilët kanë respektuar ligjet e Kosovës dhe janë dëbuar pa një procedurë të duhur ligjore dhe pa prova", ka thënë Edward Joseph.

Në lidhje me atë se përveç ndikimit politik, Turqia ka edhe një prani të fortë ekonomike në vend, ai tha se nuk ka dyshim se investimet ekonomike mund të blejnë ndikim në politikë. "Kjo është e qartë në të gjithë botën. Pyetja për Kosovën është, ku e

shihni të ardhmen tuaj, përfshirë atë ekonomike? Cili, në fund, është tregu më i madh për investime dhe ai për thithjen e investimeve, Evropa Perëndimore me tregjet më tërheqëse në botë, apo Turqia? Kosova ka nevojë për investime. Kështu që është e kuptueshme që Kosova dëshiron investimet turke. Ajo që është më e vështirë për t'u kuptuar në këtë rast është dorëzimi para presionit të Ankarasë pa respektuar së pari ligjet ndërkombëtare dhe procesin që duhet ndjekur për ekstradimin e personave. Kosova

mund të ketë marrëdhënie të mira ekonomike me Turqinë, në të njëjtën kohë të mos shkelë detyrimet e saj ndaj Bashkimit Evropian ose të mos i dëmtojë marrëdhëniet me Brukselin", ka thënë Joseph. Ai ka shtuar se është e vërtetë që Turqia është një vend i madh, por kjo nuk do të thotë se Kosova duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë të saj. "Ka mënyra të ndryshme për t'iu përgjigjur kërkesave të vendeve të tjera. Një krahasim interesant do të ishte ai me përgjigjen e ShBA-së ndaj kërkesës së Turqisë për ekstradimin e Gulenit, udhëheqësin e lëvizjes që Erdogan insiston se është organizatore e përpjekjes për grusht shteti. ShBA-ja nuk e ka refuzuar në mënyrë zyrtare kërkesën turke për ekstradim dhe as kryeministri Haradinaj e as presidenti Thaçi nuk kanë nevojë të ofendojnë Erdoganin ose Turqinë. Ata mund të përgjigjen duke thënë se i kuptojnë shqetësimet e tij dhe se do t'i hetojnë rastet duke respektuar rregullat dhe procedurat në fuqi", ka thënë Joseph.



Thaçi, pjesëmarrës në Samitin e Sofjes

Prishtinë, 6 prill - Çështja e pjesëmarrjes së Kosovës kishte vënë në pikëpyetje Samitin në mes të BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, që do të mbahet në muajin maj në Sofje të Bullgarisë.

Kryeministri i Spanjës, Mariano Rajoy, i kishte thënë homologut të tij, Boyko Borissov, se ai mund të mos shkonte nëse pjesëmarrës ishte presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Bullgaria, si kryesuese e radhës e Këshillit të BE-së, ka vënë prioritet afërimit e

Ballkanit Perëndimor me BE-në dhe për këtë ka organizuar samit të BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor në Sofje të Bullgarisë. Kontesti me Spanjën është pasqyruar këtë javë edhe në mediet e Bullgarisë, por edhe në ato të Brukselit.

Të premten është sqaruar se samiti do të mbahet dhe se Kosova do të marrë pjesë aty. "KosovaPress" ka siguruar ftesën e Bashkimit Evropian dhe Bullgarisë si kryesuese, për pjesëmarrje në këtë samit për

presidentin Thaçi, e cila mban datën e 23 marsit 2018.

Kjo ftesë shihet se është nënshkruar nga presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, nga presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker dhe nga kryeministri i Bullgarisë, Boyko Borissov. Bullgaria, e cila aktualisht mban Presidencën e Këshillit të BE-së, do të presë në muajin maj udhëheqësit e 27 vendeve të BE-së dhe të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Meta: Qeveria të jetë më e interesuar për dialog me opozitën

TIRANË, 6 PRILL - Në një kohë kur politika zien nga tensionet e përplasjet në mes të opozitës dhe mazhorancës, ku "molla e sherrit" është bërë taksa për Rugën e Kombit, vjen reagimi i presidentit Ilir Meta. Në një deklaratë për mediet presidenti dha mesazhin e qartë se mes palëve duhet të ketë dialog.

Presidenti tha se Qeveria duhet të jetë më shumë e interesuar të ketë

dialog me opozitën, por edhe opozita duhet t'i shfrytëzojë hapësirat ligjore për më shumë kontroll parlamentar. "Mesazhi im ka qenë i qartë; opozita ka mundësitë t'i shfrytëzojë instrumentet e saj për ta rritur kontrollin parlamentar, por edhe mazhoranca duhet të jetë më e interesuar për dialog të qëndrueshëm me opozitën dhe të gjithë shqiptarët për të evituar çdo shkak për tensione të

panevojshme dhe konflikte që nuk i shërbejnë as vendit dhe as qytetarëve", tha ai.

Po ashtu, Ilir Meta foli edhe për protestën e Rugës së Kombit. "Taksa, e drejtë e komunitetit të ketë kërkesë llogarë. Protesta forcon ndjenjën e llogaridhënies së Qeverisë. Shpresoj në një reflektim dhe në dialog për çështjen. Dialogu ndihmon në përmirësimin e qeverisjes së vendit", tha Meta.



Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka përsëritur sërish të premtën kërkesën për zgjedhje të reja

LDK-ja paralajmëron mocion mosbesimi ndaj Qeverisë

Shefi i Grupit Parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka paralajmëruar se nëse partitë politike nuk pajtohen për caktimin e datës së zgjedhjeve të reja, ky subjekt politik do ta ngrehë mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë së Kosovës. Ai ka deklaruar se Qeveria e drejtuar nga Haradinaj është Qeveri e pakicës dhe, si e tillë, nuk mund t'i adresojë temat e mëdha për vendin. Kurse zyrtarët e koalicionit qeverisës kanë mohuar mundësinë e mbajtjes së zgjedhjeve të reja

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 6 PRILL - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka paralajmëruar ngritjen e një mocioni mosbesimi ndaj Qeverisë Haradinaj. Shefi i Grupit Parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka treguar se rrëzimi i Qeverisë do të vijë në shprehje nëse subjektet politike nuk pajtohen për caktimin e një date për zgjedhje. "Ne kemi ofruar opsionin tonë për një tryezë të përbashkët të partive politike për t'u marrë vesh për një datë të zgjedhjeve dhe vendimet që duhet të ndodhin në ndërkohë. Sepse është me rëndësi që zgjedhjet të mos mbahen me ngut brenda 30 ditëve. Nëse kjo nuk ndodh, ne jemi të obliguar ta çojmë përpara mocionin e votëbesimit për Qeverinë", ka thënë Hoti të premtën në një konferencë për medie.

Ai ka deklaruar se Qeveria e drejtuar nga Haradinaj është qeveri e pakicës dhe, si e tillë, nuk mund t'i adresojë temat e mëdha për vendin. "Vendi nuk mund të qeveriset më tutje nga kjo Qeveri e pakicës. Si rezultat, temat e mëdha nuk mund të adresohen nga kjo Qeveri, në veçanti dialogu me Serbinë. Po

flitet shumë për këtë marrëveshjen gjithëpërfshirëse përfundimtare me Serbinë, por kjo nuk mund të arrihet me këtë pakicë parlamentare. Të keni parasysh se janë rreth 350 mijë vota shqiptare që janë në opozitë, në krahasim me mbi 200 mijë vota që janë në pozitë. Si rezultat i këtyre zhvillimeve vendi detyrimisht duhet të shkojë në zgjedhje jo vetëm pse dëshiron LDK-ja, por sepse vendit i duhet një qeveri stabile, me viziton të qartë", është shprehur Hoti. Madje, sipas tij, me largimin e Listës Serbe kjo Qeveri mund të konsiderohet e rënë. "Me daljen e Listës Serbe nga Qeveria faktikisht tani vendi udhëhiqet nga pakica. Kjo Qeveri mund të konsiderohet e rënë. Është më se e qartë se vendi nuk mund të vazhdojë më tutje që të udhëhiqet nga kjo Qeveri", ka thënë Hoti.

Por, përfaqësuesit e koalicionit qeverisës kanë mohuar mundësinë e lëkundjes së Qeverisë.

Madje ditë me parë kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka ironizuar me këtë kërkesë të LDK-së, duke thënë se edhe koalicioni qeverisës është për zgjedhje. "Për të shkruar në zgjedhje edhe Aleanca dhe koalicioni qeverisës ia jep votat (LDK-së)



Hoti kritikon Thaçin e Haradinajn

Shefi i Grupit Parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka kritikuar kryeministrin Ramush Haradinaj për mungesën në seancën e jashtëzakonshme, në të cilën është debatuar për deportimin e shtetasve turq. "U vlerësua nga shumica e deputetëve se kryeministri ka

dështuar ta kryejë detyrën e vet, obligimin ligjor dhe kushtetues për ta siguruar zbatimin e plotë të të drejtave elementare njerëzore dhe t'i ketë nën mbikëqyrje institucionet përkatëse. Ndërkaq presidenti ka tejkaluar kompetencat kushtetuese", ka thënë Hoti.

nëse është për zgjedhje", kishte deklaruar Haradinaj në një konferencë me gazetarë.

Kurse deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Zenun Pajaziti, ka thënë për "Epokën e re" se kjo Qeveri duhet ta vazhdojë agjendën shtetërore. "Agjenda e shtetit të

Kosovës duhet të vazhdojë të ecë përpara me këtë Qeveri, me këtë opozitë dhe me këto parti politike. Bile ky rast duhet të shërbejë për vetëdijesimin e Listës Serbe se e ardhmja e vendit tonë nuk do të ngecë dhe nuk do të varet nga tendenca e Beogradit për ta manipuluar agjendën e

institucioneve të Kosovës përmes deputetëve që i ka në Kuvend", ka thënë Pajaziti. Ai ka deklaruar se zgjedhjet e reja tani nuk janë interes shtetëror. Madje, sipas tij, kundër zgjedhjeve të reja është edhe bashkësia ndërkombëtare. "Ne nuk mund t'u ikim procedurave demokratike që janë të parapara me ligj dhe Kushtetutë. Kushdo qofshin ata, nëse i përmbushin procedurat ligjore, ne nuk mund t'u ikim atyre. Në këtë rast edhe zgjedhjet nuk janë tabu. Të gjithë duhet të jemi të gatshëm që të përballemi me diçka që është ligjore dhe kushtetuese. Mendoj se tani duhet t'i shikojmë interesat e vendit dhe të qytetarëve, të cilat na thonë se ne nuk duhet t'u ikim përgjegjësiëve tona. Në këtë rast, do të duhej të kemi pjesëmarrje më aktive edhe të opozitës në proceset e rëndësishme për vendin, siç është dialogu me Serbinë", ka thënë Pajaziti.



Jahjaga në Dublin kërkon thellimin e bashkëpunimit me Irlandën

PRISHTINË, 6 PRILL (ER) - Ish-presidentja e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga, është takuar të premtën në Dublin me presidentin e Irlandës, Michael D. Higgins, me të cilin ka biseduar për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve. Ajo ka bërë me dije se ka pasur një takim të përzemërt me presidentin e Irlandës, Michael D. Higgins. "Në takim diskutuam mundësitë për thellimin e marrëdhënieve ndërmjet vendeve

tona, me theks të veçantë tek procesi i integritimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare. Po ashtu folëm për rëndësinë e pajtimit në rajonin e Ballkanit Perëndimor si parakusht për një të ardhme paqësore të rajonit brenda Unionit Evropian", ka thënë Jahjaga. Ajo ka shtuar se Irlanda është një nga vendet e para që ka njohur Kosovën shtet vetëm pak kohë pas shpalljes së pavarësisë në shkurt të vitit 2008.

FLET PËR "EPOKËN E RE", JAKUP KRASNIQI

Zhvillimet e fundit politike më së paku i janë dashur vendit



Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh kryetar i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, ka thënë se zhvillimet e fundit nuk i janë dashur shtetit dhe pasojat e tyre do të shihen më vonë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se karshi këtyre zhvillimeve Kuvendi dhe Qeveria janë treguar të pafuqishme meqë fuqia është koncentruar në pushtetin ceremonial. Krasniqi ka porositur Haradinajn ta qeverisë vendin si kryeministër pasi këtë të drejtë ia jep Kushtetuta. Në situatën kur as pozita dhe as opozita nuk e kanë shumicën në Kuvend, ish-kryeparlamentari ka thënë se edhe mund të shkohet në zgjedhje por, sipas tij, nuk do të ketë zgjidhje të duhur. "Ata që po kërkojnë zgjedhje ishin para pak muajve në qeverisje dhe nuk e zgjidhen asnjë problem", është shprehur Krasniqi

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 6 PRILL - Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka thënë të premtën se pasojat e zhvillimeve të fundit politike do të shihen më vonë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se karshi këtyre zhvillimeve Kuvendi dhe Qeveria janë treguar të pafuqishme meqë fuqia është koncentruar në pushtetin cere-

monial. "Zhvillimet e fundit politike, kështu si kanë ndodhur, më së paku i janë dashur vendit tonë. Ndoshta dhimbja më e madhe është se krijuesi i kësaj situatë politike tepër të dëmshme për Kosovën dhe qytetarët e saj, është krijuar nga njeriu i parë i vendit i cili veç si unifikues i politikës sonë do të duhej të ishte edhe garantues i kushtetutshmërisë dhe i ligjshmërisë. Pasojat e këtij veprimi druaj se do të shihen më vonë. Shkurt, këto zhvillime

antikushtetuese e antiligjore nuk i janë dashur vendit. Dikush duhet të marrë përgjegjësi morale, mbase edhe më shumë", ka deklaruar Krasniqi. Pavarësisht se koalicioni qeverisës ka trashëguar probleme të mëdha politike, ai ka thënë se Nisma Socialdemokrate, në kuadër të kapaciteteve të veta, është duke i kryer mirë detyrat. "Axhamillëqet kanë filluar herët. Krijuesit ose krijuesi i problemeve të fundit politike, kanë treguar se

dikush është i predispozuar të krijojë probleme politike. Dhe na kujton atë thënie: 'Ujku do mjegull'. Sa i përket Nismës si pjesë e koalicionit qeverisës, në fuqinë ose në kapacitetet e saj është duke i kryer mirë detyrat e veta", është Krasniqi. Në një situatë kur as pozita dhe as opozita nuk e kanë shumicën në Kuvend, Krasniqi ka thënë se edhe mund të shkohet në zgjedhje por, sipas tij, zgjidhje të duhur nuk do të ketë. "Në një situatë të tillë, numrat nuk i ka asnjëra palë. Në situatë të tilla do të duhej të krijohet një konsensus për zgjedhje të parakohshme. Ndërsa ata që po kërkojnë zgjedhje para pak muajve ishin në qeverisje dhe nuk zgjidhen asnjë problem, veç sa i zvarriten, mbase edhe i ndërlikuan. Në një situatë të tillë edhe mund të shkohet në zgjedhje, por zgjidhje të duhur nuk besoj se do të ketë. E gjithë çështja është si ta nisim një fillim të ri e të mbarë.

Deri më tani zgjedhjet as edhe një herë nuk na kanë sjellë kryeministër e as kabinet të mirë në mirëqeverisje e racional në formë e në përmbajtje", ka theksuar ai. Krasniqi ka folur edhe për dialogun me Serbinë, duke thënë se problemet që i kanë krijuar marrëveshjet e Brukselit, për një kohë të gjatë do të jetë gur i rëndë në qafë të Kosovës. "Konsideroj se ai që po kërkohet nuk është unitet, veçse nëse është unitet për ta krijuar 'Zajednicën?!', ka thënë ai.

"Epoka e re": Z. Krasniqi, si i keni parë zhvillimet e fundit në skenën politike?

Krasniqi: Ky koalicion qeverisës ka trashëguar probleme të mëdha politike. Zhvillimet e fundit politike, kështu si kanë ndodhur, më së paku i janë dashur vendit tonë. Ndoshta dhimbja më e madhe është se krijuesi i kësaj situatë politike

shumicën e thjeshtë në Kuvend. A mund të mbijetojë kjo Qeveri në këto rrethana?

Krasniqi: Në një situatë të tillë numrat nuk i ka asnjëra palë. Në situatë të tilla do të duhej të krijohet një konsensus për zgjedhje të parakohshme. Ndërsa ata që po kërkojnë zgjedhje para pak muajve ishin në qeverisje dhe nuk zgjidhen asnjë problem, veç sa i zvarriten, mbase edhe i ndërlikuan. Në një situatë të tillë edhe mund të shkohet në zgjedhje, por zgjedhje të duhur nuk besoj se do të ketë. E gjithë çështja është si ta nisim një fillim të ri e të mbarë. Deri më tani zgjedhjet as edhe një herë nuk na kanë sjellë kryeministër e as kabinet të mirë në mirëqeverisje e racional në formë e në përmbajtje.

"Epoka e re": Si e komentoni kërkesën e partive opozitare për zgjedhje të reja. Ka gjasa që as ky mandat të mos shkojë deri në fund?

Krasniqi: Ajo që mund të them unë është: partia që po i kërkon zgjedhjet ishte pjesë e të gjitha problemeve, përfshirë edhe 'Zajednicën'. Opinioni e di mirë vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Personalisht jam për një debat të mirëfilltë në shoqërinë tonë, por e gjithë çështja është a kemi kapacitete politike për një debat të tillë. Unë jam më shumë se skeptik për këtë çështje. Debat, ndoshta, do ta gjente një zgjidhje më të mirë! Por, sa në Kosovë ka vullnet politik për këtë?

"Epoka e re": Sa jeni i kënaqur me punën e Qeverisë Haradinaj nga njeriu i parë i vendit, i cili veç si unifikues i politikës sonë do të duhej të ishte edhe garantues i kushtetutshmërisë dhe i ligjshmërisë. Pasojat e këtij veprimi druaj se do të shihen më vonë. Shkurt, këto zhvillime antikushtetuese e antiligjore nuk i janë dashur vendit. Dikush duhet të marrë përgjegjësi morale, mbase edhe më shumë. Rasti në fjalë ka nxjerrë në shesh dy probleme të mëdha. I pari, institucioni më i lartë i shtetit, Kuvendi, po tregohet i pafuqishëm, njëkohësisht edhe Qeveria si pushteti më i fuqishëm po tregohet i pafuqishëm dhe fuqia është koncentruar në pushtetin ceremonial. Kjo nuk është e mirë për vendin.

teper të dëmshme për Kosovën dhe qytetarët e saj, është krijuar nga njeriu i parë i vendit, i cili veç si unifikues i politikës sonë do të duhej të ishte edhe garantues i kushtetutshmërisë dhe i ligjshmërisë. Pasojat e këtij veprimi druaj se do të shihen më vonë. Shkurt, këto zhvillime antikushtetuese e antiligjore nuk i janë dashur vendit. Dikush duhet të marrë përgjegjësi morale, mbase edhe më shumë. Rasti në fjalë ka nxjerrë në shesh dy probleme të mëdha. I pari, institucioni më i lartë i shtetit, Kuvendi, po tregohet i pafuqishëm, njëkohësisht edhe Qeveria si pushteti më i fuqishëm po tregohet i pafuqishëm dhe fuqia është koncentruar në pushtetin ceremonial. Kjo nuk është e mirë për vendin.

"Epoka e re": Koalicioni qeverisës tashmë ka mbetur edhe pa



ShBA-ja rikonfirmon përkrahjen për transformimin e FSK-së në ushtri

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë pritur të premten në takime të ndara drejtorin për Evropën Qendrore dhe Jugore të ShBA-së, Matthew Palmer, nga i cili kanë marrë mbështetjen e plotë për perspektivën euroatlantike të Kosovës dhe për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 6 PRILL - Drejtori për Evropën Qendrore dhe Jugore të ShBA-së, Matthew Palmer, ka qëndruar të premten për vizitë zyrtare në Kosovë. Gjatë kësaj vizite ai është pritur në takime të ndara nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj.


Gjatë takimit me Palmerin, presidenti Thaçi ka thënë se Kosova është e përkushtuar për paqe të qëndrueshme në rajon. "Kosova është e gatshme për fazën përfundimtare të dialogut me Serbinë dhe është e përkushtuar për gjetjen e një zgjidhje të përhershme që forcon paqen në

rajon dhe në tërë kontinentin e Evropës", është shprehur presidenti Thaçi.

Ndërsa drejtori për Evropën Qendrore dhe Jugore të ShBA-së, Matthew Palmer, ka rikonfirmuar edhe një herë përkrahjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për rrugëtimin evropian të Kosovës. Presidenti Thaçi dhe drejtori Palmer kanë vlerësuar se vetëm dialogu çon drejt stabilitetit rajonal dhe paqes afatgjatë, si dhe mbetet mekanizmi i vetëm dhe i pazëvendësueshëm për zgjidhjen e problemeve në rajonin tonë.

Pas takimit me Thaçin, drejtori Palmer është pritur në takim edhe nga kryeministri Ramush Haradinaj. Pas këtij takimi ai ka

theksuar se ShBA-ja do ta mbështesë transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri. "Ishte një bisedë përmbajtësore me drejtorin për çështjet e Evropës Qendrore dhe Jugore të ShBA-së, Matthew Palmer, për intensifikimin e agjendës shtetërore të Kosovës drejt normalizimit të raporteve me Serbinë, liberalizimin e vizave dhe hapjen e një dinamike të re drejt perspektivës euroatlantike të vendit tonë. Departamenti i Shtetit i ka qëndruar afër Kosovës në të gjitha etapat e shtetndërtimit dhe do ta mbështesë edhe në transformimin e FSK-së në ushtri. Kosova është me fat që e ka ShBA-në aleate strategjike dhe partneren më të besueshme", ka deklaruar Haradinaj.



Romët kërkojnë përkrahje më të madhe nga institucionet e Kosovës

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Komunitetit Rom, kryetar i romëve të Kosovës, Albert Kinolli, gjatë takimit me presidentin dhe kryeministrin, është shprehur i kënaqur me përfshirjen e komunitetit rom në institucionet shtetërore, por ka theksuar se qytetarët e këtij komuniteti kanë nevojë për përkrahje më të madhe

EPOKA
ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 6 PRILL - Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Komunitetit Rom, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të premtën në takim deputetin, njëherësh kryetar i romëve të Kosovës, Albert Kinolli, si dhe personalitete të tjera të këtij komuniteti, të cilët janë pjesë e institucioneve të vendit në pozita të rëndësishme.

Kryeministri Haradinaj me këtë rast, duke i uruar për ditën e tyre, ka thënë se kosovarët kanë pasur gjithmonë raporte korrekte me komunitetin rom. Ai ka thënë se Qeveria do të punojë që në të ardhmen të kenë përfqësime më të avancuar në arsim dhe punësim nga ky komunitet.

Përfqësuesit e komunitetit rom kanë falënderuar kryeministrin Haradinaj për përfqësimin e komunitetit rom në institucionet e vendit, si dhe për përkrahjen e vazhdueshme financiare. "Jemi të befazuar nga pritja dhe përkrahja juaj për këtë komunitet. Ne jemi të përfqësuar në të gjitha nivelet dhe institucionet duke qenë pjesë

edhe e vendimarrjes", është shprehur kryetari i romëve në Kosovë, Albert Kinolli.

Për nder të kësaj dite, Zyra e Kryeministrit ka mbajtur edhe një koktej rasti, ku të pranishëm ishin përfaqësues nga institucionet dhe organizatat e ndryshme nga vendi, përfaqësues të ambasadave dhe përfaqësues të këtij komuniteti.

Në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve, kryeministri Haradinaj ka falënderuar komunitetin rom për partneritetin që tregon në qeverisje dhe në tema që janë me interes dhe rëndësi për Kosovën. "Nuk do të ndalemi në punë së bashku dhe besoj se çdo pengesë që na del përpara do ta zgjidhim së bashku. Kemi hartuar strategjinë, por është koha e implementimit të kësaj strategjie dhe jam i bindur se në zbatim të strategjisë do të gjejmë jo vetëm përkrahjen për këtë strategji, por edhe vullnetin e ndërsjellë të të gjitha niveleve të institucioneve tona, edhe të atyre komunale, në mënyrë që komuniteti rom, kur ta fillojë shkollimin, të jetë i përkrahur edhe me tekste shkollore dhe të mësojë në gjuhën e vet", ka thënë Haradinaj.



Thaçi uron komunitetin rom për Ditën Ndërkombëtare

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, të premtën ka pritur një delegacion të komunitetit rom të kryesuar nga kryetari i Partisë Rome, Albert Kinolli. Duke i uruar për Ditën Ndërkombëtare të Komunitetit Rom, presidenti Thaçi ka pohuar se, pavarësisht prej rritjes së përkrahjes dhe legjislacionit modern e afirmativ për komunitetet në Kosovë, ky komu-

nitet ende po ballafaqohet me kushte më të vështira të jetesës. "Kemi përmirësim të gjendjes, mirëpo mbetet edhe shumë punë për të bërë, që së bashku ta përmirësojmë mirëqenien e qytetarëve të të gjitha komuniteteve, me theks të veçantë të komunitetit rom", është shprehur presidenti Thaçi. Ndërsa kryetari i Partisë Rome, Albert Kinolli, u

shpreh i kënaqur me përfshirjen e komunitetit rom në institucionet shtetërore, por ka theksuar se qytetarët e këtij komuniteti kanë nevojë për përkrahje më të madhe. "Edhe në ditë feste të komunitetit rom dhe të kulturës sonë ne do të përipiqim ta rrisim ndërgjegjësimin për problemet me të cilat përballet komuniteti ynë", ka deklaruar Kinolli.

Nënshkruhet memorandumi për programin e vullnetarëve të Korpusit të Paqes

PRISHTINË, 6 PRILL (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi dhe drejtoresha për Kosovë e Korpusit të Paqes, Darlene Grant, kanë nënshkruar të premtën memorandumi mirëkuptimi, i cili përcakton rolet dhe përgjegjësitë e të dyja palëve në mbështetje të aktiviteteve që lidhen me Programin e Vullnetarëve të Korpusit të Paqes në Kosovë.

Në këtë ceremoni, e para që është nënshkruar nga institucionet e Kosovës në rezidencën e ambasadorit të ShBA-së në Kosovë, Greg Delawie, ministri Bytyqi ka theksuar rëndësinë që ka puna e vullnetarëve të Korpusit të Paqes për përmirësimin e mësimdhënies së gjuhës angleze në Kosovë, por edhe për shkëmbimin kulturor. "Deri më sot Kosova ka mirëpritur 120 vullnetarë, për të cilët shkollat tona dhe familjet tona kanë hapur dyert dhe kanë punuar e jetuar së bashku", ka



thënë ministri Bytyqi, duke rikonfirmuar përkrahjen e vazhdueshme për Programin e Korpusit të Paqes. "Këtë partneritet do ta vazhdojmë ta rrisim dhe ta kultivojmë së bashku, duke e thelluar edhe më tej

raportin e veçantë dhe miqësor në mes të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës", është shprehur ministri Bytyqi. Ndërsa ambasadori Delawie e ka përmendur si shembull të mirë faktin se nga 25 vullnetarët që

gati kanë përfunduar shërbimin e tyre, janë katër persona të cilët do ta vazhdojnë shërbimin edhe për vitin e tretë apo edhe të katërtin sepse, sipas tij, konsiderojnë se puna e tyre ende nuk ka përfunduar dhe

kanë ndjenjë të fortë përkushtimi ndaj Kosovës. "Bashkëpunimi ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Korpusit të Paqes hap dritare të reja të mundësive për nxënësit, veçanërisht ata nëpër fshatra, të cilët ndryshe nuk do të kishin qasje në mësimin e gjuhës angleze me dikë që gjuhën angleze e ka gjuhë amtare", ka deklaruar ambasadori Delawie. Ndërsa drejtoresha për Kosovë e Korpusit të Paqes, Darlene Grant, ka theksuar se me programin e hapur në vitin 2014, Korpusi i Paqes në Kosovë është nderuar të jetë vendi i 140 në shërbim në historinë e Korpusit të Paqes. Memorandumi i nënshkruar të premtën bazohet në marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara në lidhje me Programin e Korpusit të Paqes, të nënshkruar më 9 shtator 2013.

Ngrihet aktakuzë për rastin 'Pronto'

PRISHTINË, 6 PRILL (ER) - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ka ngritur të premtën aktakuzë për rastin e njohur "Pronto", ku protagonist kryesor është ish-shefi i grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Adem Grabovci. Bashkë me Grabovcin, aktakuza përfshin edhe 11 persona me funksione të larta zyrtare, ku bëjnë pjesë edhe ministri aktual Besim Beqaj dhe deputeti Zenun Pajaziti. Po në akuzë përmenden edhe dy ish-sekretarë të përgjithshëm, një ish-zëvendësiministër, këshilltarë politikë si dhe drejtorë të ndërmarrjeve publike dhe zyrtarë nga pushteti lokal. Sipas Prokurorisë Speciale, të pandehurit akuzohen për kryerjen e veprës penale, shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës në bashkëkryerje.

Të pandehurit, sipas aktakuzës, kanë keqpërdorur pozitat e tyre zyrtare duke bashkëpunuar në mes vete për dhënie të privilegjeve dhe përparësive të kundërligjshme për personat të cilët kanë konkurruar në funksione të rëndësishme.

Në aktakuzë është trajtuar çështja penale e punësimeve dhe ndarjes së posteve të bazuara në përkatësinë partiake dhe raporte personale, problem për të cilin një kohë të gjatë alarmojnë qytetarët e Kosovës, agjencitë për zbatimin e ligjit, mediat dhe shoqëria civile.

Ky rast ishte njoftuar nga mediat publike, duke zbuluar veprimet dhe metodat e punësimit brenda grupeve të ngushta të interesit, në bazë të së cilës është nisur hetimi i prokurorisë, i cili rezultoi me ngritjen e aktakuzës, thuhet në komunikatën e Prokurorisë Speciale.



Jagxhillari: Këtë vit do të bëhen reforma të thella në administratë

Ministri i Administratës Publike, Mahir Jagxhillar, ka bërë me dije se 2018-a do të jetë vit i reformës së administratës publike. Ai ka theksuar se për të pasur reformë funksionale dhe efektive duhet të ketë zyrtarë publikë të cilat janë pranuar në punë sipas meritës. Jagxhillari ka treguar se ky proces kërkon miratimin e pakos ligjore në të cilën përfshihen tri projektligje të rëndësishme

EPOKA
ERE

Faton DERMAKU

PRISHTINË, 6 PRILL - Nën organizimin e Ministrisë së Administratës Publike të premtën është mbajtur takimi për finalizimin e hartimit të pakos legjislative që ka të bëjë me reformën e administratës publike. Me këtë rast ministri i Administratës Publike, Mahir Jagxhillar, ka thënë se me pakon ligjore në të cilën bëjnë pjesë Projektligji për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, Projektligji për zyrtarët publikë dhe Projektligji për pagat, synohet ndërtimi i bazës së administratës shtetërore. "Këto tri projektligje, bashkë me Ligjin për procedurat e përgjithshme administrative, përbëjnë pako

ligjore reformuese të administratës. Në këtë aspekt 2018-a do të jetë vit i reformave të thella në administratën publike. Për këtë ju ftoj që ta shfrytëzojmë këtë moment dhe t'i miratojmë këto projektligje me të cilat do të mund të realizohen këto synime kryesore", ka deklaruar ai, duke shtuar se për t'i realizuar këto synime në mënyrë funksionale dhe efektive duhet të ketë zyrtarë publikë të cilët janë pranuar në punë sipas meritës.

Jagxhillar ka treguar se Projektligji për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura do ta rregullojë organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura që funksionojnë në kuadër të Kuvendit. "Me këtë projektligj janë paraparë rregulla

sa i përket administratës shtetërore duke përfshirë sistemet ministrore dhe organet brenda këtij sistemi. Për herë të parë ky projektligj vendos rregulla për agjencitë e pavarura si për nga aspekti i themelimit dhe funksionimit të tyre, duke përfshirë edhe qeverisjen dhe organizimin e brendshëm, por edhe raportimin e tyre te Kuvendi. Ky projektligj parasheh rregulla edhe sa i përket ndryshimit strukturor dhe shuarjes së organeve të administratës", ka thënë ai.

Kurse Projektligji për Zyrtarët Publikë, Jagxhillari ka bërë me dije se ka për synim të përcaktojë rregulla sa i përket marrëdhënies së punës për zyrtarët publikë të bazuar në profesionalizëm dhe meritë. "Për nga fushëveprimi ky ligj rregullon marrëdhënien e punës për zyrtarët publikë të cilët

janë: nëpunësit civilë, nëpunësit e shërbimeve publike, nëpunësit e kabineteve dhe nëpunësit teknikë dhe administrativë", ka theksuar ai, duke shtuar se Projektligji për paga do t'i rregullojë pagat për të gjithë përfuturit që marrin pagë nga buxheti i shtetit.

Jagxhillari ka theksuar se parimi kryesor i këtij projektligji do të jetë, pagë e njëjtë për punën të njëjtë. Ndërkaq zëvendëskryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, Safete Hadergjonaj, ka thënë se Kosova është përballur me shumë probleme për shkak të mungesë të këtyre ligjeve. Sipas saj, këto tri ligje rregullojnë një problematikë mjaft të ndjeshme siç është çështja e pagave. Hadergjonaj ka thënë se është një numër i madh i agjencive të pavarura që nuk kanë rregullim të pagave. Ajo ka deklaruar se

reforma e administratës publike është një hap para në integrimet evropiane. Kurse koordinatori nacional për reforma shtetërore, Besnik Tahiri, ka thënë se një dekadë pas pavarësisë, Kosova është afër procedimit të tri ligjeve kyçe që rregullojnë organizimin, funksionimin dhe pagat e administratës shtetërore. "Pakoja e ligjeve është element thelbësor i reformës në administratën publike dhe pjesë e agjendës për reforma evropiane. Kjo pako e ligjeve vendos përfundimisht rend, strukturë dhe barazi. Institucionet e Kosovës mbeten thellësisht të përkushtuara në këtë proces, por ky proces, para së gjithash, kërkon konsensus nga të gjithë aktorët politikë, civilë dhe, para së gjithash, mbështetje teknike dhe financiare nga donatorët", është shprehur Tahiri.

Fermerët t'i fillojnë përgatitjet për mbjelljet pranverore



Prof. dr. Imer RUSINOVCI

Tani është koha t'i filloni parapërgatitjet për mbjelljet pranverore dhe të ndërmerrni hapat konkretë për parapërgatitjet e mbjelljeve pranverore të bimëve të arave. Afati optimal i të cilave në mënyrë të drejtpërdrejtë varet sa nga kushtet klimatike-

tokësore, aq edhe nga datat e caktuara kalendarike për llojet e veçanta të kulturave pranverore. Afati i parapërgatitjes së tokës për mbjelljet pranverore është i një rëndësie të veçantë, sepse nga ky operacion agroteknik varet realizimi i prodhimeve që ju planifikoni t'i realizoni. Parapërgatitjeve të duhura të tokës për mbjelljet e kulturave pranverore u ka parapri punimi themelor i tokës i zbatuar në vjeshtë, përkatësisht në fillim të dimrit, me kusht që temperaturat gjatë këtij operacioni të rëndësishëm agroteknik të punimit themelor (lavrimin bazë) të mos kenë qenë nën

minus 5 gradë celsius. Avantazhi i lavrimin themelor që ju e keni zbatuar në vjeshtë, do t'ju krijojë shtresë kultivuese të shkrihtë për mbjelljet pranverore, me strukturë më të mirë të pjesës sipërfaqësore, shtresë tokësore të shkrihtë dhe homogjene të pjesës së rizosferës, si rezultat i ngricave dimërore dhe oscilimeve të shpejta e të shpeshta temperaturale që mbretëruan deri më tani. Punimi themelor i zbatuar në vjeshtë do t'ju akumulojë sasi më të madhe të lagështisë në pjesën e profilit fiziologjik aktiv si rezultat i reshjeve dimërore, me ç'rast në ngastrat tuaja do të

krijohen kushte më të favorshme për përvetësimin e materieve ushqyese të tretura në lagështi efektive, gjatë kësaj periudhe vegetative, karakteristike kjo shumë e rëndësishme për shfrytëzimin e pjellorisë së tokës. Me punimet e duhura parapërgatitore të tokës për mbjelljet pranverore, përkatësisht punimet parambjellore në ngastrat tuaja kultivuese, ju mund t'i realizoni këto qëllime: -Ruajtjen e lagështisë së grumbulluar në tokë nga reshjet dimërore, kontakte me të suksesshme të farërave me tokën me lagështi të mjaftueshme; - Përmirësimin e regjimit ujor,

ajror dhe temperaturar; - Stimulimin indirekt të aktiviteteve mikrobiologjike; - Inicimin e mbirjes së barërave të këqija; - Homogjenizimin e pjesës sipërfaqësore të tokës për mbjellje. Përgatitjet parambjellore (diskimet, cilindrimet, kultivimet, trinimet, rrafshimet), duhet të zbatohen 7-10 ditë para mbjelljeve të kulturave pranverore. Thellësitë e punimeve parambjellore, varësisht nga tipi i tokës, prania e lagështisë dhe lloji i kulturave që planifikohen të mbillen, zbatoni në thellësi prej 10-15 cm.

Kurti thotë se me këtë qeveri është i pamundur zhvillimi ekonomik



PRISHTINË, 6 PRILL (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë të premtën se buxheti i Kosovës është tejet i ngjashëm nga viti në vit. Sipas tij, gati gjysma e buxhetit është për paga e mëditje dhe mallra e shërbime, çereku shpenzime kapitale

(3/4 aty në asfalt) si dhe po aq subvencionet e transferimet. "Të hyrat vetjake të komunave të Kosovës (gjysma prej të cilave tatim në pronë) nuk janë as 50 milionë euro në vit. 30 herë më shumë janë të hyrat tatimore e të cilat përbëjnë mbi 2/3 e të hyrave

buxhetore (me ç'rast afër 90 % të tyre janë tatimet indirekte: TVSh, dogana dhe akcizë). Në vitin 2017 nuk pati fare të hyra nga fitimet e nxjerra nga korporatat përmes dividendave. Ndërkaq, tatimi në të ardhurat e korporatave ishte 75 milionë euro apo

vetëm 5 % e të hyrave tatimore", ka thënë Kurti. Ai ka thënë se me këtë strukturë dhe këso shifra është i pamundur zhvillimi ekonomik dhe rrugëtimi evropianin i Kosovës. "Është e vërtetë se në Kosovë duhet të ndërrojë qeveria, sepse duhet të ndrysho-

jë buxheti: të hyrat dhe shpenzimet, planifikimi dhe realizimi i këtyre, gjithnjë në dritën e një vizioni zhvillimor socio-ekonomik për të ardhmen, e jo nën hijen e një administrimi dembel për mbijetesë në tashmen", ka deklaruar Kurti.

Hapet konkursi për drejtor menaxhues të KEK-ut

Prishtinë, 6 prill (ER) - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka shpallur konkursin për drejtor menaxhues të kësaj kompanie. Kandidatët të cilët dëshirojnë

të aplikojnë për këtë pozitë duhet të kenë diplomë universitare në lëmin e administrimit të biznesit, ekonomisë, financave, inxhinierisë apo juridikut. Po

ashtu, kandidatët duhet të kenë së paku pesë vjet përvojë pune, duke përfshirë edhe përvojën e punës së suksesshme në poste të larta drejtuese.

Konkursi për drejtor menaxhues të KEK-ut do të jetë i hapur deri më 20 prill. Deri më tani drejtor menaxhues i KEK-ut ka qenë Arben Gjuka.



BERZh-i do ta ndihmojë Kosovën në sektorin privat, ekonominë e gjelbër dhe infrastrukturë

Shefi i Zyrës së BERZh-it në Prishtinë, Neil Taylor, ka bërë me dije se BERZh-i do ta ndihmojë Kosovën në sektorin privat, ekonominë e gjelbër dhe infrastrukturë. Ai ka thënë se që nga viti 2012 janë investuar 312 milionë euro në 81 projekte nga sektori publik dhe ai privat në Kosovë

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 6 PRILL - Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) do ta mbështesë Kosovën në sektorin privat, ekonominë e gjelbër dhe infrastrukturë. Kështu ka thënë të premten shefi i Zyrës së BERZh-it në Prishtinë, Neil Taylor, në takimim e iniciuar nga Qeveria e Kosovës, ku ishin të pranishëm edhe përfaqësuesit e komunave dhe bizneseve private.

Taylor ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për organizimin e këtij takimi, duke theksuar se BERZh-i është një partner afatgjatë për Kosovën. Taylor ka thënë se që nga viti 2012 janë investuar 312 milionë euro në 81 projekte nga sektori publik dhe ai privat në Kosovë. "Duam të bëjmë më tepër në Kosovën dhe ky është qëllimi ynë, që të punojmë më shumë. I kemi tri fusha prioritare: sek-

torin privat, ekonominë e gjelbër dhe infrastrukturën", ka thënë shefi i BERZh-it, duke pohuar se ekziston mundësia që të bëhet më shumë në projektet që kanë impakt në rritjen ekonomike.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë Kosova do t'u japë peshë raporteve me BERZh-i. Ai ka thënë se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar që projektet jetike të komunave të kenë përkrahjen e duhur, nga e cila përkrahje do të përmirësohet jeta e qytetarit. "Qeveria e Kosovës do të marrë garanci, që ky operacion i përbashkët të bëhet i mundur dhe nismat e komunave dhe bizneseve ta gjejnë përkrahjen e duhur. Është një veprim i ndërsjellë yni dhe ky operacion i përbashkët bëhet i mundur duke falënderuar gatishmërinë e BERZh-it, e cila i falënderoj për këtë partneritet. Besoj se kemi dëshmuar si Kosovë se do t'i japim peshë



kësaj marrëdhënie dhe besoj se takimi i sotëm përmballë një pjesë tjetër të kësaj marrëdhënie, që dëshmon se do të rrimë në këtë projekt bashkë", ka thënë kryeministri Haradinaj. Koordinatori në Qeverinë e Kosovës për Ballkanin Perëndimor, Gazmend Abrashi, njëherësh i ngarkuar edhe në mbledhjen e projekteve dhe prezantimin e tyre, ka prezantu-

ar 40 projektet me të cilat Kosova këtë vit është prezantuar në Londër. Ndërkaq kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka paraqitur projektet të cilat komuna në udhëheqjen e tij nuk mund që t'i realizojë me buxhetin që ka. "Komuna e Drenasit ka dy projekte. Njërin për trajtimin e ujërave të zeza, tjetrin për grumbullimin e ujit të

pijshtëm", ka thënë Lladrovci. Ky takim i iniciuar nga kryeministri Haradinaj pati për qëllim avancimin e mëtutjeshëm të këtyre projekteve për ta gjetur mundësinë më të shpejtë të investimit dhe realizimit të tyre. Institucionet e përfshira në këtë proces tani do t'i listojnë projektet prioritare të cilat do të mbështeten nga BERZh-i dhe Qeveria e Kosovës.

Punëtorët e Postës kërkojnë ndihmë nga Qeveria

PRISHTINË, 6 PRILL (ER) - Punëtorët e Postës së Kosovës ende nuk i kanë marrë pagat e tyre. Arsim Mehmeti nga Posta e Kosovës ka njoftuar përmes një komunikate për medie se kjo ndërmarrje edhe në ditën e gjashtë të muajit prillit nuk ka mundur që t'i ekzekutojë pagat për punonjësit e tyre. Mehmeti ka thënë se gjendja e kësaj ndërmarrje mbetet ende e rëndë. "Vonesat në kryerjen e obligimeve të pagave për punonjësit na kanë shqetësuar shumë, ndërkaq reagimet dhe kërkesat e sindikatave për ekzekutim të pagave i konsiderojmë të drejta", është thënë në njoftimin për medie.

Më tej në këtë njoftim janë bërë me dije edhe shkaqet pse Posta e Kosovës ndodhet në këtë gjendje. "Ne kemi kërkuar me kohë mbulimin e humbjeve që kemi në shërbimin universal postar përmes dhjetëra shkresave zyrtare drejtuar Qeverisë. Edhe pse është obligim ligjor mbulimi i këtij shërbimi i cili rrjedh nga Ligji mbi shërbimet postare dhe mar-

rëveshja e nënshkruar nga MZHE dhe Posta e Kosovës, ku precizohet qartë se kur Posta nuk mund t'i mbulojë shpenzimet e këtij shërbimi, Qeveria duhet ta mbulojë humbjen. Ne ende nuk kemi asnjë vendim pozitiv në këtë drejtim", është bërë me dije në njoftimin për media.

Mehmeti në këtë njoftim ka treguar se përmbaruesi privat, por edhe Gjykata Themelore në Prishtinë kanë dhënë qëndrimin e tyre se Qeveria është e obliguar t'i paguajë Postës 3 504 341.89 euro, përfshirë në këtë vlerë kamatën dhe shpenzimet e tjera deri në datën kur janë nxjerrë vendimet. Faktor tjetër që po ndikon në vonesat e ekzekutimit të pagave të punonjësve, sipas Mehmetit, është vonesa e Telekomit të Kosovës për kryerjen e obligimeve kontraktuale që ka me Postën e Kosovës. Ai ka theksuar në këtë njoftim për medie se Posta e Kosovës do ta kalonte krizën shumë shpejt po të kishte veprime konkrete nga ana e Qeverisë së Kosovës.



PËR NJË MARRËVESHJE TË ARRITUR, IMPROVIZIME TË LODHTA!



**Behxhet Sh. SHALA -
BAJGORA**

Marrëveshje historike apo përpjekje historike: Kohët e fundit po qarkullon një ofertë apo premtim, kryesisht nga presidenti Hashim Thaçi, për një "marrëveshje historike" me Serbinë, pas së cilës, kur ajo të nënshkruhet dhe ta marrë formën e detyrimit për palët, Kosova dhe Serbia do ta njohin njëra-tjetrën dhe, në këtë mënyrë, do të përmbyllej konflikti apo mosmarrëveshja e madhe historike midis serbëve dhe shqiptarëve. Ky farë premtimi nuk është asgjë tjetër përveç një mashtrim i radhës i atyre që udhëhoqën deri më tani bisedimet "teknike" midis Beogradit dhe Prishtinës, me lehtësimin jashtëzakonisht shtrëngues dhe dhunues tuajja vetëm për Kosovën, së pari të Baroneshës Ashton e tash të Federica Mogherinit. Ne kishim vetëm dy "negociatorë", njëra teknike, mashtruesja Edita Tahiri dhe tjetri "politik", improvizuesi Thaçi që, përkthyer në shqip, i bie të jetë Edita Tahiri i gjinisë mashkullore!. Ekipe përcjellëse të Tahirit ishin kryesisht familjarë të Edita Tahirit, kurse ekipi i Thaçit përbëhej kryesisht nga puthadorë dhe puthakëmbë të Thaçit apo llaskuçë dhe pakurizorë profesionistë. Alfa dhe omega i këtyre "ekspertëve" për bisedime ishte Çollaku, një konformist karrierist dhe shëtitës postesh. Një kohë ishte "kryenegociator" Isa Mustafa, si kryeministër dhe i tërë përfitimi i tij ishin honorarët për takime, dalja në fotografi me Mogherinin për album jetësor apo ndonjë kontroll mjekësor, pasi që

ishte trajtuar më parë në Bruksel. Të gjithë jemi dëshmitarë se bëhej be dhe rrëfe se me Serbinë nuk do të kishte bisedime politike, pa e njohur pavarësinë e Kosovës, kush ka qenë budalla ka besuar, kurse ne që nuk kemi besuar jemi shpallur antiamerikanë dhe antievropianë sikur edhe kundërshtarë të ecjes së Kosovës drejt proceseve integruese apo, nëse u referohemi mashtruesve dhe rrenacakëve ordinerë, integritet në NATO, BE, liberalizimit të vizave dhe anëtarësimit në shoqatën e dilberëve të Jakovës dhe sofrës pejane të jaranëve. Në bisedime kanë shkuar sikur kur ne shkonim në orën e gjuhës serbe në shkollën e mesme e që ishte fakultative (jodetyruese) apo nxënësit dhe studentët e sistemit paralel arsimor të viteve 1990-1998 e që tërë kapitalin për mësim-nxënien e kishin një fletore apo edhe pa asgjë, kur dolën analfabetë serialë të cilët pastaj, në Universitetin e Prishtinës, u pajisën me tituj akademikë, me punime shkencore, si: kallashnikov, ministër apo deputetë, komandant i zonës operative të Leshit, futja e beretës italiane apo Sig Sauerit në vesh të profesorëve jobashkëpunues për ta dëgjuar muzikën e kalibrut 9 mm ose, edhe më të madh, të Magnumit, të botuara në të gjitha revistat shkencore të universiteteve të Al Kapones, Pablo Eskobarit, Fidel Kastros, Homeinit dhe shkencëtarëve dhe kontribuuesve të tjerë në përhapjen e arsimit, për të mirën e njerëzimit. Për Edita Tahirin kanë qenë me rëndësi butikët e Brukselit, kurse për Hashim Thaçin puthja me Ashtonën, Mogherinin, përqafimi i përzemërt me Daçiqin, Nikoliqin e sidomos me Aleksandër Vuçiqin. Si inspirim për këtë mundim aq të madh për kombin dhe Kosovën i ka shërbyer interesimi i njëanshëm (politikisht unilateral) ndaj

përkthyeses sharmante të Ivica Daçiqit që, të jemi të sinqertë, është bingo pas përqafimit me Ketrin Ashtonin apo Federica Mogherinin. E keni parë ekipin përcjellës të dy kryenegociatorëve legjendarë për bisedime "teknike me Serbinë", ose kanë mbajtur çanta, çadra, pallto apo ndonjë kondom rezervë në xhepat e tyre. Kurrë nuk ka pasur asnjë paraqitje publike për "rezultatet" në këto bisedime dhe janë mbuluar me faktin se e kanë të ndaluar deklarinim dhe se për këtë janë përgjegjës "lehtësuesit", në ndërkohë që Serbia, në kohën kur po bisedohej për normalizimin e marrëdhënieve, e pengonte Kosovën për t'u anëtarësuar edhe në Shoqatën e Gjuetarëve sikur edhe në Korporatën për Tredhje të Mizave si institucione jashtëzakonisht të rëndësishme për perspektivën evropiane të Kosovës. Bashkësia ndërkombëtare nuk merrej fare me Serbinë përveçse i vardisej për liberalizim të vizave dhe procese të tjera integruese, kurse nga Kosova kërkonte ta bëjë demarkacionin e kufirit me Malin e Zi ku gjithashtu humbi territor (ndoshta jo 8200 hektarë) sikur edhe ta luftojë krimin e organizuar dhe korrupsionin në Kolumbi, Guatemalë, Singapor dhe Tanzani. Të gjitha i pranuan negociatorët tanë legjendarë. Në historinë e luftërave dhe përpjekjeve për ndërtimin e paqes përmes bisedimeve, nuk mund ta gjeni asnjë rast sikur ky i Kosovës kur negociatorët analfabetë dhe lakmitarë, shtetin që ka bërë aq shumë krime në Kosovë, që i ka bërë njëqindmijë të zeza dhe që vazhdon të bëjë shumë të këqija edhe sot dhe i cili haptas deklaroi se kurrë nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës, e ka bërë partner përcaktues për çështje të brendshme të

Kosovës dhe të cilat nuk do t'i pranonte as shteti i cilësuar si Banana Republikë. Nuk mund të gjeni vend sikur Kosova që shteti që ka kryer gjenocid në Kosovë dhe i cili e mban të okupuar 30 % të territorit të trajtohet në këtë mënyrë, siç po trajtohet Serbia. Serbia i ka organizuar zgjedhjet lokale dhe të përgjithshme në Kosovë, ka ndërtuar, financuar dhe i mirëmban strukturat paralele në të gjitha sferat e jetës, kurse ju paloseni para saj sikur vejtashat e Gostivarit. Nuk ka logjikë që t'i krijoni aq shumë favore Serbisë apo që të pranoni aq shumë lëshime edhe kur kjo nuk kërkohet nga ju. I kemi dy skajshmëri: e para, pala kosovare në këto negociata ishte shumë inferiore, e dorëzuar fare. Kurse, e dyta opozita kosovare, e lodhtë deri në rraskapitje, duke i hedhur goglat në tavolinë sikur ta kishte përkrahjen 100 % të Kinës, materiale, ushtarake dhe logjistike i refuzon bisedimet apo shtron aso kërkesa që për qëllim e kanë refuzimin e bisedimeve përmes bisedimeve. Dhe pastaj e kritikon pozitën për dorëzim para Serbisë. Krejtësisht kemi qenë të papërgatitur për bisedime duke mos e pasur të qartë as qëllimin final dhe duke e vendosur injorancën personale, të shoqëruar me përfitime personale politike dhe materiale, para interesit të përgjithshëm, kombëtar dhe shtetëror. Të padijshmit dhe mashtruesit nuk mund të jenë as kombëtarë e as shtetformues e lëre më ndërtues të paqes. Të tillë ishin dhe janë negociatorët tanë legjendarë!

Formula, diçka jep e diçka merr te ne interpretohet si vetëm jep dhe asgjë nuk merr. Po e shohim se Serbia, përveçse po i pengon njohjet e reja, po i bind dhe po i detyron disa shtete, nga ish-Lëvizja e të painkuadruarve, që njohjet e zyrtarizuara tani t'i tërheqin.

Kungji kryesor, thënë shqip apo strumbullari i bisedimeve (me gjuhë intelektuale, shihe ti, intelektuale!!!) është presidenti post-historik, Lartmadhëria e Tij, Hashim Thaçi i Parë, i cili e ka privatizuar 100 % procesin e negociatave.

Tash po flet për një marrëveshje historike, pasi ia kanë botuar biografinë në librin: "New state, new statemen - A Pornography" duke shpresuar se do të bëhet pjesë e historisë dhe, së bashku me Vuçiqin, do ta fitojnë Çmimin Nobel për Paqe, sikur Perez me Arafatin. Jam i bindur se një marrëveshje me Vuçiqin është arritur dhe tani vetëm po punohet se si të ambalazhohet në mënyrë që të menaxhohet opinioni duke deklaruar se e kemi arritur maksimumin e së mundshmes dhe se miqtë ndërkombëtarë na kanë sugjeruar ta bëjmë këtë. Edhe budallai e ka të qartë se në një proces të bisedimeve, asnjëra palë nuk e fiton maksimumin, ndryshe pse do të duhej të bisedohej?! Edhe këtu Serbia po del të jetë fituese absolute, nga humbës 100 %, çka të fitojë është fitore për të. Me Asociacionin po luhet lojë e ndyrë, derisa shqiptarët e cilësojnë si Asociacion i Komunave me Shumicë Serbe, serbët e Kosovës dhe Serbia e cilëson si Asociacion i Komunave Serbe. Madje ata e kishin bërë edhe logon, me katër 'S' cirilikë brenda kryqit dhe vetëm mungojnë brenda atyre katër 'S' cirilikë fotografitë e Millosheviqit, Drazha Mihajloviqit, Alkesandër Rankoviqit dhe Arkanit për t'u kompletuar mozaiku çetnik dhe shovinist i Serbisë në Kosovë. Në të njëjtën kohë Kosovës i është imponuar një flamur i cili përjashton çdo identifikim me Shqipërinë, një himn pa tekst që nuk ia çon as Kazanovës në mesin e 40 bukurosheve, një stemë pa përmbajtje etj. Ky është zbatim i standardeve të dyfishta.

Paralelisht me formimin e

Nisin punimet në asfaltimin e dy rrugëve në Runik të Skenderajt

SKENDERAJ, 6 PRILL (ER) - Në Runik të Skenderajt kanë filluar të premtën punimet në asfaltimin e rrugëve lokale në

lagjen "Miftaraj" dhe "Dautaj". Me rastin e fillimit të këtyre punimeve, kryetari i Komunës së Skenderajt,

Bekim Jashari, ka thënë se këto dy rrugë kanë rëndësi të madhe për banorët e kësaj ane.



Asociacionit i cili, nuk kam asnjë dyshim, do të formohet duke pasur për bazë marrëveshjen në Bruksel dhe jo vërejtjet e Gjykatës Kushtetuese, marrëveshje për të cilën po këmbëngul Serbia dhe serbët e Kosovës, kurse ndërkombehtarët pa asnjë dyshim se do ta pranojnë këtë duke bërë disa ndryshime kozmetike që e ruan përmbajtjen ekzekutive të këtij Asociacioni, kosovarët do të detyrohen ta pranojnë mendimin e shumicës sepse kjo është vlerë demokratike. Serbia, bashkësia ndërkombehtarë dhe serbët e Kosovës përbëjnë shumicën, kurse kosovarët janë pakicë absolute. Ndryshe, ku keni parë rast të ngjashëm në botë ku konstatohet se keni bërë 24 shkelje të Kushtetutës, por se mund të vazhdohet me formimin e Asociacionit!! A ju ka rënë të lexoni interpretim më idiotesk se ky?! Sigurisht se jo, në vendet normale vetëm për një shkelje të Kushtetutës rrëzohet marrëveshja dhe nënshkruesit detyrohen të japin dorëheqje. Për këtë arsye injorantët juridikë në Kosovë bëhen anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Në botë nuk mund të gjeni kesi rastesh. Për këtë arsye edhe jemi rast sui generis!

Për ta mashtuar opinionin se, kinse, paralelisht me bisedimet me Serbinë po punohet edhe për gjykimin e krimeve të luftës në Kosovë, u pati formuar një institut i eunuhëve i emërtuar si Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës, me ambicie t'i ngajë Institutit të Simon Vizentalit në Vjenë e që nuk e ka pasur efektin as sa një pordhë e Simon Vizentalit. Derisa Kosova nuk ka investuar fare në këtë institut, as në aspektin material e as në aspektin profesional, Izraeli ka ofruar fonde të pakufizuara për Institutin e Simon Vizentalit. Simon Vizentali ka qenë hebre i bindur dhe ka qenë në gjendje të vdesë në çdo kohë për sqarimin e fatit vetëm edhe të një viktime çifute, kurse këta të institutit të eunuhëve, me përjashtime të vogla, kanë kontribuar që Kosova të ketë viktime dhe as që iu ka bërë zemra vër për viktime. Mashtruesit e politikës e fshehën formimin e këtij institucioni vetëm që Baca Adem Demaçi të mos jetë në krye të këtij instituti. Shihni tash çfarë statusi ka Instituti i Eunuhëve për "Hulumtim" të

Krimeve të Luftës në Kosovë e që kishte pretendime të jetë sikur Instituti Simon Vizental. Janë shndërruar në eunuhë që i ruajnë gratë e haremit të Sulltanit! Ishte formuar, nën përkujdesjen e Hashim Thaçit, një grup ndërmintor për ballafaqim me të kaluarën dhe pajtim dhe që një kohë ishte nën Isa Mustafën: Pasi Hashimi u bë president, me ambasador dhe terminale, ky grup thjesht nuk përmendej më, tani dëshiron ta formojë Komisionin për të Vërtetën dhe Pajtimin, me ndihmën e disa mercenarëve ndërkombehtarë, gjykatës dhe gazetarë, ndonëse ky komision duhet të jetë pronë e Kosovës. Pa asnjë dyshim ky komision, të cilin ia pati refuzuar Baca Adem menjëherë pas luftës kryeadministratorit Kushner, do ta përcjellë fatin e bisedimeve në Bruksel dhe nuk do të prodhojë asnjë rezultat për viktimat sikur që po trumbetohet. Për ta bërë më sqarues punën e këtyre përpjekjeve të Hashim Thaçit për të Vërtetën dhe Pajtimin me Serbinë, e cila nuk na bënë hesap për pesë para, dua t'ju tregoj një barsoletë jo fort të hijshme: "Një femër bukuroshe, duke shkuar për një vizitë te një mike në një vend tjetër e humbet rrugën, prandaj e pyet kalimtarin e parë, që ishte mashkull se ku gjendet shtëpia e filan fishekes dhe ai ishte i gatshëm ta shoqërojë, deri te vendi. Rrugës, i joshur nga bukuria e jashtëzakonshme, e dhunon vajzën duke ia shqyer gardërobën dhe duke e lënë gjysmëlakuriqe. Vajza e dhunuar e mbledhë disa veten, mbulohet me ato pak rroba të mbetura dhe në ato çaste vjen një burrë tjetër që thjesht tmerrohet me ato pamje. Vajza i tregon për dhunimin, kurse burri zemërmirë e mbulon me pallton e vet duke i ofruar ndihmë për ta gjetur shtëpinë e mikes. Në ndërkohë, edhe këtij mashkulli i kërcen kandari dhe e dhunon vajzën, edhe më keq. E dhunuar, e poshtëruar dhe e rraskapitur vajza shtrihet në tokë dhe në atë çast vjen mashkulli i tretë i cili edhe mund të jetë i mirë por, vajza mosbesuese, me të drejtë, nuk e lejon të flasë fare por i thotë, bërë edhe të atë që e kanë bërë dy veta para teje dhe vazhdoje rrugën...". Prandaj, edhe ti Hashim, lëri ato komisione dhe improvizime dhe bëje edhe ti me ne atë punën sepse ne i kemi lëshuar brekët. Sikur që edhe ju i keni lëshuar brekët në Bruksel! Dhe jua kanë bërë dhe po jua bëjnë të njëjtën punë!



Beqaj i ofron bashkëpunim KFOR-it zviceran

MALISHEVË, 6 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Beqaj, ka pritur të premtën udhëheqësin e ri të KFOR-it zviceran në Malishevë, kapitenin Wieland Schmid. Kryetari Beqaj ka thënë se Komuna e Malishevës do ta vazhdojë bashkëpunimin me KFOR-in sikurse deri më tani. Ai ka

thënë se prania e KFOR-it është një mbështetje e rëndësishme për komunën që drejton. "Ju garantoj se bashkëpunimi i mirë me KFOR-in do të vazhdojë edhe në të ardhmen, prandaj ju ndihuni si në shtëpinë tuaj", u ka thënë Beqaj përfaqësuesve të KFOR-it zviceran. Beqaj ka falënderuar për

bashkëpunimin e mirë edhe drejtuesin e deritanishëm të LMT-së të KFOR-it zviceran, kapitenin Daniel Wyss, i cili ishte i pranishëm në këtë takim. Edhe drejtuesit e LMT-së e kanë falënderuar kryetarin Beqaj dhe Komunën e Malishevës për bashkëpunimin e mirë dhe korrekt që kanë pasur.

Ujësjiellësi Rajonal 'Prishtina' intervenon në teatër dhe bibliotekë

PRISHTINË, 6 PRILL (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka takuar të premtën kryeshefin ekzekutiv të Kompanisë së Ujësjiellësit Rajonal "Prishtina", Ilir Abdullahu, me të cilin ka biseduar për problemet e fundit me të cilat janë përballur Teatri Kombëtar dhe Biblioteka Kombëtare nga ujërat e zeza në hapësirat e nëndheshme të tyre. Gashi dhe Abdullahu u pajtuan për t'i koordinuar veprimet për eliminimin e problemeve që kanë këto dy institucione në

objektet e tyre. Ministri Gashi e ka falënderuar menaxhmentin e ujësjiellësit për reagimin e shpejtë dhe gatishmërinë e treguar. "Dua të shfrytëzoj rastin t'ju falënderoj për intervenimin e shpejtë që keni bërë për eliminimin e ujërave gjatë ditës së sotme", ka thënë Gashi. Ai ka kërkuar nga drejtuesit e kompanisë së ujësjiellësit që bashkërisht të zhvillojnë një projekt për eliminimin e rrezikut që shkakton depërtimi i ujërave në këto dy institucione kombëtare të kulturës,

me ç'rast të dy u pajtuan t'i harmonizojnë veprimet. "Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit mbetet e përkushtuar të ndajë buxhet shtesë për zgjidhjen e kësaj problematike", është shprehur ministri Gashi. Ndërsa kryeshefi i kompanisë, Ilir Abdullahu, shfaqti gatishmërinë dhe mbështetjen e plotë të Ujësjiellësit Rajonal "Prishtina" që bashkërisht me institucionet, ministrinë dhe komunën, t'i koordinojnë veprimet dhe ta sanojnë gjendjen e tanishme.



Prizreni vendos shenjat në rrugët e qytetit

Prizren, 6 prill (ER) - Drejtoria e Shërbimeve Publike në Prizren është duke vazhduar punimet në rrugët

e kësaj komune. Si prioritet nga kjo drejtori janë marrë vendkalimet e këmbësoreve dhe pengesat në rrugë. Sipas

një njoftimi për medie, është bërë me dije se faza e parë për vendosjen e shenjave në rrugë është gati në për-

fundim, ndërsa faza tjetër e punimeve do të vazhdojë me vendosjen e pengesave në rrugë.



Orbani në rrugë për mandatin e tretë

Shumica e sondazheve tregojnë se partia djathtiste Fidesz e Orbanit, në skenarin më të keq, mund ta fitojë shumicën e thjeshtë duke u bërë kryeministri i dytë që ka shërbyer më së gjati brenda një vendi të BE-së, pas kancelares gjermane Angela Merkel

BUDAPEST, 6 PRILL - Kryeministri nacionalist i Hungarisë, Viktor Orbán, synon ta fitojë mandatin e tretë radhazi në zgjedhjet parlamentare të së nesërme (e diel), pas fitoreve bindëse më 2010 dhe 2014.

Shumica e sondazheve të opinionit tregojnë se partia djathtiste Fidesz e Orbanit, në skenarin më të keq, mund ta fitojë shumicën e thjeshtë.

Orbani është kryeministri i dytë që ka shërbyer më së gjati brenda një vendi të Bashkimit Evropian, pas kancelares gjermane Angela Merkel. Ai ka udhëhequr opozitën e krahut lindor të bllokut kundër një sistemi të kuotave - të mbështetur nga Merkel dhe Brukseli - për shpërndarjen e migrantëve nëpër vende të BE-së. Orbani, po ashtu, është kundërshtari kryesor i përpjekjeve për ta thelluar integrimin e bllokut. Votuesit hungarezë do të zgjedhin 199 anëtarë të parlamentit, në një rreth të vetëm të zgjedhjeve.

Disa sondazhe thonë se pjesëmarrja mbi 70 për qind e votuesve mund të sinjalizojë një mobilizim efikas të opozitës, që mund të bëjë që Fidesz ta humbasë shumicën parlamentare. Pjesëmarrja e lartë mund të shtyjë edhe disa parti më të vogla të opozitës nën pragun prej 5% të hyrjes në Parlament. Kandidatët e opozitës duhet të fitojnë në 40 deri në 45 qarqe për t'i mohuar shumicën Fideszit, thotë Tibor Zavecz nga qendra e sondazheve, Zavecz, raporton "Reuters".

Gjithnjë sipas sondazheve, partia opozitare Jobbik pritet të dalë e dyta. Jobbik e ka përjashtuar mundësinë e koalicionit me Fideszin.

Rregullat e zgjedhjeve janë



ndryshuar nga Fidesz qysh në vitin 2010, duke i rritur shanset e partisë në pushtet përballë opozitës së ndarë majtiste dhe partisë së krahut të djathtë Jobbik.

Numri i ulësve që duhen fituar në Parlament është ulur nga 386 në 199 në vitin 2011.

Rrethi i dytë i votimeve është eliminuar, duke ua mohuar palëve mundësinë e bërjes së marrëveshjeve midis raundeve - gjë që ka kontribuar në ndarjen e opozitës aktuale.

Qeveria e Orbanit u ka dhënë hungarezëve etnikë të drejtën për shtetësi. Ata mund t'i votojnë listat e partive me letër. Sipas të dhënave të Zyrës Kombëtare të Zgjedhjeve, 378 000 shtetas të tillë janë regjistruar për zgjedhjet e këtij viti. Shumica e

tyre mbështesin Fideszin.

Votimet me postë elektronike janë nxjerrë jashtë ligjit për qindramijëra hungarezë të rëndomtë që punojnë jashtë vendit dhe që nuk janë domosdoshmërisht mbështetës të Fideszit.

Të enjten Komiteti për të Drejta të Njeriut i Kombeve të Bashkuara ka lëshuar një raport për Hungarinë, duke e kritikuar atë për një sërë çështjesh, përfshirë thellimin e gjuhës së urrejtjes.

Zëvendësdhëheqësi i Komitetit, Yuval Shany, tha se koha e publikimit të vlerësimit nuk ka të bëjë me procesin zgjedhor. Sipas këtij vlerësimi, gjuha e urrejtjes në politikë dhe media shënjestron grupet pakicë në Hungari, përfshirë myslimanët, migrantët dhe refugjatët.

LAJME SHKURT

ShBA-ja vendos sanksione ndaj oligarkëve rusë



WASHINGTON, 6 PRILL - Departamenti Amerikan i Thesarit ka vënë sanksione të reja kundër Rusisë, përkatësisht ndaj 24 personave dhe 14 subjekteve, duke përfshirë disa zyrtarë të lartë që besohet të kenë lidhje të ngushta me presidentin rus Vladimir Putin.

Në emrat e bërë publikë të premten përfshihet manjati Oleg Deripaska, udhëheqësi i gjigantit rus, Gazprom, Aleksei Miller, ish-truproja e Putinit, Viktor Zolotov, sekretari i Putinit në Këshillin e Sigurisë, Nikolai Patrushev. Këta janë disa nga zyrtarët dhe manjatët më të njohur rusë që shënjestrohen nga ShBA-ja, si ndëshkim për veprimet e Moskës, përfshirë ndërhyrjen e saj të dështuar në zgjedhjet presidenciale të ShBA-së më 2016. Në mesin e shumë personave të tjerë janë edhe ish-kryeministri dhe shefi i inteligjencës së Jashtme, Mikhail Fradkov, ministri i Brendshëm rus, Vladimir Kolokoltsev dhe manjati Viktor Vekselberg.

Macron: Putini ta ndërpresë përkallëzimin ushtarak në Siri

PARIS, 6 PRILL - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, i bëri thirrje homologut rus, Vladimir Putin, t'i kërkojë Damaskut ndërprerjen e përkallëzimit ushtarak në Siri, në kuadër të



mbrojtjes së civilëve dhe për t'i rifilluar negociatat e paqes, theksoi presidenca franceze. Gjatë një bisede telefonike, Macron i kërkoi Rusisë ta ushtronte influencën e plotë ndaj regjimit sirian, për t'i dhënë fund përkallëzimit ushtarak të konstatuar gjatë muajve të fundit, për ta mundësuar mbrojtjen e popullsisë civile, rifillimin e besueshëm të negociatave për një tranzicion politik gjithëpërfshirës dhe parandalimin e çdo rishfaqjeje të ISIS-it në rajon", theksoi Elyse. "Kjo, për të mundësuar mbrojtjen e popullsisë civile, rifillimin e besueshëm të negociatave për një tranzicion politik gjithëpërfshirës dhe për të parandaluar çdo rishfaqje të ISIS-it në rajon", tha presidenca franceze.

Puigdemonti lirohet nga burgu gjerman

BERLIN, 6 PRILL - Një gjykatë gjermane vendosi se ish-udhëheqësi i Katalonjës, Carles Puigdemont, nuk mund të ekstradohet në Spanjë nën akuzat për kryengritje dhe mund të lirohet nga burgu me dorëzani.

Gjykatësit në Schleswig në Gjermaninë Veriore e mbështetën vendimin e tyre në ligjet gjermane duke theksuar që ndërsa kryengritja mund të jetë krim në Spanjë, në Gjermani nuk është vepër penale. Gjykatësit gjithashtu thanë se

Puigdemonti ende mund të ekstradohet në Spanjë nën akuzat për shpërdorim të fondeve publike, por jo për kryengritje.

Pas dorëzimit prej 75 mijë eurosh, Puigdemonti mund të largohet nga Gjermania vetëm me lejen e prokurorit, t'i informojë autoritetet për ndryshimin e adresës dhe të paraqitet një herë në javë në polici.

Kataloniasit pro pavarësisë, kremtuan vendimin e gjykatës gjermane, i cili nuk është komentuar ende nga autoritetet

spanjolle.

Policia gjermane arrestoi më 25 mars Puigdemont në bazë të një fletarrestimi të lëshuar nga Spanja. Ai hyri në Gjermani nga Belgjika ku kishte ikur tetorin e kaluar për ta shmangur arrestimin. Ai kërkohet nga Spanja nën akuzat për kryengritje pasi që vitin e kaluar sfidoi qeverinë qendrore duke çuar përpara synimet për pavarësinë e Katalonjës, duke nxitur ndërhyrjen e dhunshme policore. Me akuzat për kryengritje përballen edhe 24 udhëheqës të tjerë separatistë katalanas.



Këndvështrim për trilogjinë "Gjergjat në drita përkrenarësh" të shkrimtarit Avni Dehari

TRIOLOGJI PËR ÇDO SHTËPI

Lulëzim ETEMAJ

"Dragoi", "Udhëkryqi", "Flakadanët e lirisë" janë romanet për fëmijë, të cilët autori Avni Dehari i ka përmbledhur në kuadër të trilogjisë me titull "Gjergjat në drita përkrenarësh", të botuar nga Shtëpia Botuese "Orfeu", këtë vit, në Prishtinë.

Siç mund të paramendohet edhe nga titulli i trilogjisë, boshiti i saj është ndërtuar mbi figurën e heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti. Koha që nga lindja gjerë tek vdekja e kryetrimt, ky është çarku kohor i shtrirë së trilogjisë.

Në librin e parë, lexuesit, përmes rrëfimit të urtë të autorit, të pasur me shprehje dhe lehtë të kuptueshëm, të shoqëruar gjithsesi herë-herë edhe me tone epike e në raste të caktuara edhe me figurshmëri dhe ngjyresë të lehtë mitike, njihen me rrethanat e lindjes së Gjergj Kastriotit, të fundit prej katër djemve; Shini (Stanishi), Rrapi (Reposhi) dhe Konstandini si dhe 4 vajzave: Maria (Mara), Elina (Angjelina), Valka (Vlajka) dhe Vila (Mamica), që kishin Gjon Kastrioti, princi i Arbërisë, dhe Vojsa, siç e pagëzoi artistikisht autori princeshën Vojsava Kastrioti. E, rrethanat e kohës, si familjare ashtu dhe ato të përgjithshme, në Arbëri, flasin për gjithçka tjetër më tepër se sa për një fëmijëri, rini dhe jetë normale të Gjergj Kastriotit, i lindur më 6 maj 1405 në Dibër.

Përmes rrëfimit të mbushur përplot dramë, ku dhimbja dhe krenaria, si e prindërve dhe e motrave, e shokëve, rrethit të Gjergjit ashtu dhe e princave e komandantëve besnik të Gjon Kastriotit, sikur bëjnë luftë kokë me kokë mes vete, se cila po ngadhënjën mbi tjetër, për të dalë në fund fitimtare dhe kthyer në forcë ndjenja e krenarisë për sakrificën që po bëhej për Arbërinë, duke e dërguar Gjergjin, në moshën 16-vjeçare, së bashku me tre vëllezërit e tij, peng në oborrin e Sulltan Muratit të II-të në Adrianopojë pas thyerjes që kishte pësuar prej tij Gjon Kastrioti, në vitin 1421.

22 vitet e qëndrimit të Gjergjit në Adrianopojë, përkatësisht jeta e tij, studimet për artin ushtarak si dhe stërvitja ushtarake e tij, fitoret e korrura në betejat në Azi si dhe Titulli "Skënderbej", që i ndanë Sulltan Murati i II-të në shenjë mirënjohjeje për fitoret e arritura, e dominojnë rrëfimin e Deharit për Gjergj Kastriotin, të sjellë në librin e dytë "Udhëkryqi".

"Udhëkryqi", me të drejtë u paraqitet lexuesve nga autori si një udhëkryq i vërtetë, madje shumëdimensional. Në këtë udhëkryq na shfaqet me tone të larta dramatike jo vetëm e ardhmja e Gjergj Kastriotit, por, pas likuidimit të tre vëllezërve të tij nga ana e Sulltanit, edhe vetë jeta e Gjergjit. E, për ta bërë më të plotë dramën historike, në ndërkohë atij i vdesin edhe babai, Gjoni dhe e ëma Vojsa, ndërsa në udhëkryq të paparashikueshëm ndodhet edhe vetë Arbëria, fati dhe e ardhmja e saj.

Lidhja e fuqishme me Arbërinë, të cilën Gjergjit ia kishte forcuar edhe më tej, pas largimit nga Arbëria, babai Gjoni, edhe përmes dërgimit të emisarëve të posaçëm për t'iu ndodhur pranë, fëmijëria, lojërat, shokët, ngrohtësia dhe gëzimi i familjes, përbëjnë një mori faktorësh psikologjik shtesë, të gërshtuar bukur edhe në libër nga autori Avni Dehari, të cilat ia ushqejnë dhe ruajnë të freskët, të pavyshkur, sikur ulliri, që e ruan gjithnjë të freskët blerimin, të cilin Gjergji së bashku me shokët e mbjellë në shpat, pranë murit të Kalasë së Krujës, para se të nisej për Turqi, e të cilin Gjeloshi i Kamanit madje ia vë emrin "Ulliri i Gjergjit", kujtimin, shpresën dhe ëndrrën për t'iu kthyer në Arbërinë e tij që e donte mbi gjithçka. Dhe, Arbërinë, Gjergji s'e donte dosido. E donte të lirë. Të pavarur nga Sulltani dhe perandoria osmane. Rruga e kthimit në Arbëri, së bashku me 300 kalorës dhe ushtarë besnik, shpaloja e ndjenjave dhe emocioneve të tij të përjetuara si dhe marrja në dorëzim nga turqit të Kalasë dhe qytetit të Krujës, rrëfëhet nga Dehari në librin e tretë, "Flakadanët e lirisë".



Jemi në vitin 1443. Tashmë Arbëria, me Gjergjin e kthyer në Krujë, kthim përmes të cilit Gjergji po përmbushte edhe një nga dëshirat dhe synimet kryesore si të tija ashtu dhe të babait, Gjoni, nënës Vojsës, motrës së shtrenjtë Manë, porosia e të cilëve jo vetëm që nuk i shqitej nga koka ditën, gjatë stërvitjes me shpatë, heshtë e mburojë, apo në fushëbeteja, i shfaqej edhe natën në ëndërr, po merre frymë më lirë.

Qyteti i Krujës përjeton tri sulme të fuqishme nga ushtria osmane. Dy herë nga Murati i II-të dhe djali i tij Mehmeti dhe një herë nga ushtria e gjeneralit Evrenoz Pashës. Por Kruja nuk bie. Ushtria osmane në të tri rastet numëronte 100 mijë ushtarë. Nuk ra Kalaja e Krujës dhe as qyteti, falë trimërisë, organizimit dhe strategjisë ushtarake të Gjergj Kastriotit, komandantëve dhe bashkëluftëtarëve të tij.

Pjesë e librit të tretë është edhe përjetimi i fuqishëm, i dominuar nga epizmi, që Dehari i falë lexuesit përmes rrëfimit të tij kur e përshkruan artistikisht bukur atmosferën që e dominon mbajtjen e Lidhjes Kombëtare Arbërore, më 2 mars 1444, në kishën e Shën Kollit në Lezhë, të inicuar nga Gjergj Kastrioti, të princërve dhe fisnikëve shqiptarë, burra të mendjes dhe shpatës si Gjergj Ariani,

Andrea Topia me të nipin Tanushin, Gjon Muzaka, Lekë Zaharia, Gjergj Stres Balsha, vëllezërit Nikollë dhe Pal Dukagjini, Teodor Muzaka, Lekë Zaharia, Pjetër Spani dhe burra tjerë të Arbërisë. Lapidar na paraqitet edhe fjalimi i Gjergj Kastriotit, që e mbanë në kuvend rreth domosdoshmërisë për t'iu lidhë me besa-besë me njëritjetrin, për të bërë ushtrinë e përbashkët të rregullt, që do ta ruante të pa pushtuar Arbërinë.

"I parë midis të barabartëve, burra! Me ju, në paqe, me ju në luftë! Faqebardhë për Arbërinë!", janë fjalët me të cilat Gjergj Kastrioti ju drejtohet të pranishmëve, burra të kuvendeve dhe të shpatës, përmes të cilave autori shpalojë dhe lartëson virtyte të larta si respektin, dashurinë dhe barabarësinë që kryetrimi, tashmë i zgjedhur si drejtues dhe komandant i ushtrisë së Arbërit, ndjenë ndaj bashkëluftëtarëve të tij.

Si rezultat i Besëlidhjes së Lezhës, bashkimit të parë të madh të shqiptarëve kundër një pushtuesi, nga 30 betejat që zhvilloi Gjergj Kastrioti, u fituan 29, kurse u humb vetëm 1, ajo e Beratit si pasojë e tradhtisë.

Është përmblyllje e natyrshme, brenda frymës kastriote, përmblyllja e librit, me të edhe të

trilogjisë, që i bën autori përmes sjelljes së tregimit të thuprave dhe porosisë që përçonte Gjergji kur po jepte frymën e fundit, jo vetëm për princërit dhe bashkëluftëtarët arbërorë, që po i rrinin tek koka, por edhe për gjeneratat e tëra të shqiptarëve liridashës: vetëm bashkimi i hap rrugën pathyeshmërisë dhe fitores. Përçarja, veç thyerjes dhe humbjes, asgjë tjetër nuk mund të sjellë.

Duke i rrëfyer natyrshëm faktet historike dhe letrarizuar ato, përmes figurave të shumta artistike, fjalëve dhe shprehjeve të përzgjedhura, madje herë pas here të vjelura me kujdes edhe nga thesari ynë i pasur i krahinarizimeve, autori ia arrin ta bëjë shumë konkrete, të prekshme për lexuesit, Epokën e Motit të Madh, të kryetrimt të Arbërisë, Shqipërisë së të gjitha kohërave, Gjergj Kastriotit- Skënderbeut. Si rrjedhojë logjike, krahas njohurive të fituara historike, ndjenjës së kënaqësisë, që të dhurojnë librat që lexohen me një frymë, kategori në të cilën ia ka siguruar vendin trilogjisë së tij "Gjergjat në drita përkrenarësh", autori Avni Dehari, lexuesi, jo vetëm i riu, por dhe ai i të gjitha moshave, pas leximit do ta ndjejë pulsimin më të fuqishëm të ndjenjës së krenarisë kombëtare dhe respektit ndaj të kaluarës së lavdishme historike, posaçërisht ndaj kryetrimt, heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriotit. Përmes kësaj trilogjie, shkrimtari Avni Dehari, lexuesve iu ka bërë një nga dhuratat më të bukura të mundshme në Vitin e Gjergj Kastriotit, siç është shpallur ky vit në nderim të 550 vjetorit të vdekjes së heroit tonë kombëtar - përkrenares së Shqipërisë dhe shqiptarizms.

Hyryes së trilogjisë, i shkon përshatit përkushtimi atëror, mbushur me dashuri, i autorit, për të bijtë e humbur në rrethana të errëta. Ndërsa ia lëndon lehtë përmbajtjen dhe frymën e përbashkimit, besëlidhëse, puhiza partiake, të cilës sikur nuk ka mundur t'i shpëtojë ky përkushtim, falë rrethanave të kohës, dhimbjes që e ka goditur.

Kosova synon ta promovojë kulturën në hapësirat frankofone

PRISHTINË, 6 PRILL (ER) - Favorizimi i diplomacisë parlamentare kulturore ishte një prej temave të diskutimit në takimin që ka realizuar të premtën zëvendësiministria e Kulturës, Rinisë e Sportit, Burbuqe Bakija-Deva me Guy Mettan, deputet në Parlamentin Kantonal në Gjenevë, njëherësh drejtor ekzekutiv nga Klubi Zviceran i Shtypit dhe Tahir Shabani, president i Shoqatës së Miqësisë Franko-Shqiptare. Ndër çështjet e tjera që u diskutuan

në këtë takim ishin edhe thellimi i bashkëpunimit dhe organizimit të aktiviteteve kulturore në vazhdim të përpjekjeve të një promovimi me organizatat ndërkombëtare në mes të Kosovës me Gjenevën, në Francë dhe Bruksel.

Bakija-Deva ka theksuar se qëllimi i këtyre aktiviteteve do ta favorizojë diplomacinë parlamentare kulturore për Kosovë. Zëvendësiministria e Kulturës, çështjen e diplomacisë parlamentare kulturore e ka vlerësuar

tejet të rëndësishme dhe me interes jo vetëm për MKRS-në, por edhe për palët e tjera që promovojnë vendin tonë. "Nevoja për bashkëpunim dhe shkëmbim të përvojave të mira me partnerë dhe miq është e domosdoshme dhe pozitive. Prania kulturore e Kosovës në hapësirat frankofone është një promovim jo vetëm i kulturës, por edhe i shtetit të Kosovës", ka thënë zëvendësiministria Bakija-Deva, duke shtuar faktin që në këto vende jetojnë dhe veprojnë shumë bashkatdhetarë.



Ndërkaq deputeti zviceran u shpreh se ndihet i lumtur për gatishmërinë e institucioneve të

Kosovës për të bashkëpunuar dhe koordinuar aktivitetet në të mirë të diplomacisë kulturore.

Refugjatët në Greqi, as në det e as në tokë

“More, po shumë po vijnë ...”, thotë Ilias disi i pakënaqur. E ka fjalën për refugjatët aty pari, në kampin e Elaionasit. Jo shumë larg fluksit të turistëve në zemër të Athinës, aty po strehohen nëpër kontenierë mbi 1 500 të sapoardhur.

Janë nga ata që organet zyrtare i kanë klasifikuar si “veçanërisht të pambrojtur”: nëna me fëmijë, të mitur, njerëz me aftësi të kufizuara dhe probleme të rënda shëndetësore që presin të vazhdojnë udhëtimin e tyre në drejtim të Europës Qendrore.

Ilias, i cili në fakt quhet ndryshe dhe nuk dëshiron ta bëjë publik emrin e vërtetë të tij, punon në një kompani transporti pranë kampit. Këtu ka shumë trafik, çdo dy minuta ngarkohet ose shkarkohet nga një kamion, Ilias mban shënim. Automobilët e rëndë kalojnë nëpër rrugicat e ngushta, të shtruara keq të lag-

Dilema me azilkërkuesit

Që nga viti 2016 në Greqinë kontinentale po hapen kampe refugjatësh: Jo vetëm në Elaionas, por para së gjithash në Greqinë e veriut. Pyetja se nëse dhe sa azilkërkues vijnë, është kthyer në çështje politike. Sepse, për sa kohë që këta njerëz mbeten në kampet e mbipopuluara në ishujt lindore të Egjeut, ku patën mbërritur nga Turqia nëpërmjet detit, qeveria greke është në shënjestër të kritikës ndërkombëtare. Por, nëse ata transferohen në kontinent, ata nuk mund të kthehen më në Turqi, nëse u refuzohet kërkesa për azil. Vetëm për personat që konsiderohen si “veçanërisht të pambrojtur” – sidomos të miturit – bëhet përjashtim.

Ish-ministri i Migracionit, Jannis Mouzalas, e shpjegonte vazhdimisht se refugjatët nuk



mund të hyjnë të pjesën kontinentale, sepse kjo do të çenonte marrëveshjen me Turqinë. Por për politikën e tij restriktive ndaj refugjatëve ai kritikohet

vazhdimisht nga partia e majtë, Syriza. Në fillim të marsit, ai u detyrua të largohej nga detyra për shkaqe shëndetësore. Ndërkohë është bërë shkas për debat, një raport i gazetës gjermane “Die Welt”, ku thuhet se qeveria greke sjell shumë azilkërkues në kontinent, kthen pak në Turqi dhe i klasifikon shumë njerëz “si veçanërisht të pambrojtur”.

David Esdras, shefi i Organizatës Ndërkombëtare të Migracionit (IOM) në Greqi, e cila zyrtarisht është përgjegjëse për kampet e refugjatëve në pjesën kontinentale, nuk e pranon këtë kritikë. Miqtë tanë në Europë duhet ta kuptojnë se çdo kërkesë për azil është një rast më vete dhe duhet shqyrtuar me kujdes, sipas kriterëve të Konventës së Gjenezës”, thotë Esdras në bisedë me DW. Por nuk mund të ndodhë që njerëz nga Pakistani ose Afganistani të përjashtohen parimisht nga azili, vetëm që të kalojnë më shpejt, shton ai.

Vonesa në instancën e dytë

E vërtetë është, thotë Esdras, se kërkesat për azil mund të hetohen pak më shpejt. Në instancën e parë vendimet merren në kohën e parashikuar, zvarritjet bëhen në instancën e dytë, ku vihen në përdorim mjetet juridike. Ministri i ri i Imigracionit premton përmirësim: Në Komisionet e Kontrollit të ankesave do të rritet numri i gjykatësve, nga 12 në 20, bëri të ditur politikani i Syriza-s në fund të marsit. Megjithatë, sipas sindikatave, vonesat nuk janë aspak për shkak të mungesës së stafit. Në fund të vitit 2017 u larguan nga puna mbi 100 punonjës të Autoritetit grek të Azilit sepse u mbaroi afati i kontratës. Vetëm tre muaj më vonë, autoritetit iu lejua të punësonte punonjës të rinj. Shumë prej tyre nuk e njohin materien dhe duhet të bëjnë trajnime, ankojnë sindikatat. (gazeta-Shqip.com)



Jannis dhe Marina i mirëpresin refugjatët në lokalin e tyre

jes, mes tyre lëvizin refugjatët. “Shumë shpesh këtu vrapojnë fëmijë. Ne jemi gjithë kohës në frikë se mos na ndodh ndonjë aksident”, ankohe Ilias.

E vetmja kafene në lagjen e trishtë Elaionas është ajo e Jannisit, ku ai shërben së bashku me kolegen e tij të re, Marinën. Tek ata refugjatët janë të mirëseardhur, – sidomos kur në TV ka futboll.

“Kur luan Real-i apo Barcelona në Ligën e Kampionëve, këtu është plot dhe atmosfera është shumë e mirë”, thotë pronari me entuziazëm. Incidente thujse nuk ka, gjithçka është me qetësi e rregull: “Edhe për faktin se refugjatët i shoqërojnë punonjësit e OJQ-ve dhe rregullojnë pagesën”, shton ai. Dashamirët e futbollit që frekuentojnë lokalin e Jannisit vijnë nga Siria, Afganistani ose Bangladeshi.



Lagja athinase Elaionas duket e trishtë


Beyonce me 100 valltare në "Coachella"



Beyonce është një nga artistet që ofron performanca të shkëlqyera nëpër koncerte të ndryshme. Këngëtares gjithnjë e shohim energjike duke realizuar vallëzime të ndryshme, me dukje dhe zë të mahnitshëm.

"TMZ" raporton se ajo ka punësuar edhe disa valltare për performancën e saj në festivalin "Coachella". Numri i valltareve që do ta shoqërojnë Beyoncen në "Coachella" ka arritur në 100.

Rihanna bën për vete Milanon



Këngëtarja e famshme Rihanna ishte në Milano për promovimin e linjës së saj "make up" të quajtur "Fenty Beauty". Me një fustan lëkure, Rihanna është dukur e mrekul-

lueshme në Itali, por ajo ka rrezikuar disi pasi fustani ishte i ngushtë. Me paraqitjen e saj në Milano, 30-vjeçarja ka arritur të bëjë për vete edhe një treg të rëndësishëm si Italia.



Jennifer Anistoni, beqare dhe me dukje të re

Bukuroshja tashmë beqare, Jennifer Aniston, është parë për herë të parë që nga publikimi i lajmit për ndarjen e saj nga bashkëshorti Justin Theroux. Aniston nuk duket se ka përjetuar

keq ndarjen. Ajo duket e bukur si gjithmonë si dhe vërehet se ka bërë disa ndryshime të vogla tek flokët e saj. 49-vjeçarja kishte një dukje të thjeshtë me xhinse si dhe nuk kishte të vendosur grim.

Cardi B 'shpërthen' rrjetin me albumin e ri



Reperja më e re në tregun amerikan Cardi B ka 'shpërthyer' rrjetin me albumin më të ri muzikor 'Invasion of privacy'. Këtë javë ajo ka publikuar 13 këngë, disa

prej të cilave janë bashkëpunime me emra të njohur të muzikës. Kanë kaluar vetëm nëntë muaj nga publikimi i këngës 'Bodak Yellow', e cila numëron mbi 518 milionë klikime në "Youtube".



Autor: GAZMEND MORINA	ROK BEND I YNI MUZIKOR	ZOG I EGËR GRABITOAR, I NGJASHËM ME BUFIN	AKTORI MUÇAJ	▼	SHUMË I MADH DHE I FUQISHËM FINLANDA, ESTONIA	SOLISTJA ... BYTYQI	BATARE	EPOKA ERE	KUNDREJT HALLALLI	BISKOTË E GATUAR ME ARRA (shq.)	SHENJË QË PËRFAQËSON NJË TINGULL MUZIKOR (sh.shq.)
	AKTORJA ME FAMË BOTËRORE ANISTON (shqip.)							NDËRTESE PRANË UDHËS OSE NË QYTETE QË SHËRBENTE SI BUJTINË			
	SKUQJA E LËKURËS NGA ZGJERIMI I KAPILARËVE (med.)								ABBOTT MEDICAL OPTICS E RI ZATETA		
	KËNGËTARJA VALENTINA					SKANDALET KALLI MISRI QË VARET NË TRARËT E SHTEPISË					
	PIKTURA KISHTARE						LLOJ PAPANALLI E TRASH TEHUN				
	BASHKËT.		BARAZIM LARTËSISH, RRAFSHIM (sh.shq.) JO SHUMË								
OHAJO, PENSILVANIA				SHTRESË QË KA TË BËJË ME HËNËN			HISTORIANI ROMAK LUKRECI MARK ANTONI				ISH FUTBOLLISTI FRANCEZ BIXENTE
EPOKA ERE	ALUMIN DY ZANORE				KLUB FUTBOLLI NË ITALI THAHET				AKTORI ... PAÇINO NDERRIMI I MALLIT		
